



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. _____ Prot.,

Tiranë, më _____.2026

V E N D I M

Nr. 17, datë 8.06.2026

PËR

**MIRATIMIN PËR KËSHILLIM PUBLIK TË UDHËZIMIT “RRJETE ME KAPACITET
SHUMË TË LARTË”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Gentian Sala	Kryetar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Znj.	Diana Dervishi	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar

dhe sekretare znj. Dania Nallbani, në mbledhjen e datës 08 qershor 2026, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)” miratuar me vendimin nr.11, datë 31.03.2026, të Këshillit Drejtues të AKEP, me propozim të Drejtorisë së Administrimit dhe Menaxhimit të Burimeve të Fundme, shqyrtoi çështjen me objekt:

- Miratimin për këshillim publik të Udhëzimit “Rrjete me kapacitet shumë të lartë”,

BAZË LIGJORE:

1. Neni 108 i ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
2. Rregullore “Për procedurat e njoftimit dhe këshillimit publik”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 21, datë 07.12.2021.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Dokumenti për miratim për këshillim publik të Udhëzimit “Rrjete me kapacitet shumë të lartë”,
2. Relacioni shoqërues i projektvendimit;
3. Projektvendimi i arsyetuar,

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Ligji nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, hyri në fuqi më datë 20.12.2024, duke shfuqizuar ligjin nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ligji i ri nr. 54/2024 ka përafruar pjesërisht në legjislacionin kombëtar, Direktivën (EU) 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit “Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike” (EECC).
2. Dokumenti për këshillim publik Udhëzime për rrjete me kapacitet shumë të lartë, është hartuar në përputhje me përcaktimet e nenit 108 të ligjit nr. 54/2024 sipas të cilit: *“AKEP, nxjerr rregullore për rrjetet me kapacitet shumë të lartë bazuar në udhëzuesin e BEREC-ut për rrjetet me kapacitet shumë të lartë, dhe specifikon kriteret që duhet të plotësojë një rrjet në tregun kombëtar, për t’u konsideruar si një rrjet me kapacitet shumë të lartë, veçanërisht për sa u përket parametrave të gabimit doën and up-link bandëidh resilience error-related, vonesës dhe variacionit të saj. Kriteret, që duhet të plotësojë një rrjet në tregun kombëtar për t’u konsideruar si një rrjet me kapacitet shumë të lartë, përditësohen nga AKEP-i në mënyrë periodike, bazuar në udhëzimet përkatëse të BEREC-u*
3. Projektakti synon të harmonizojë kuadrin kombëtar rregullator me praktikën dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian (BE) duke u mbështetur në Udhëzuesin e BEREC BoR (23) 164 për rrjetet me kapacitet shumë të lartë duke përafruar legjislacionin shqiptar me *acquis communautaire* në fushën e komunikimeve elektronike dhe në përmbushjen e angazhimeve të Shqipërisë në kuadër të procesit të integritetit evropian.
4. Projekt-udhëzimi është hartuar në përputhje me objektivat strategjike të zhvillimit të sektorit të komunikimeve elektronike, të cilët synojnë zgjerimin e infrastrukturave moderne të rrjeteve broadband, rritjen e kapaciteteve të rrjeteve elektronike dhe nxitjen e investimeve në teknologjitë e avancuara të komunikimeve. Përcaktimi i kriterëve për rrjetet VHCN kontribuon në krijimin e një mjedisi rregullator të qartë dhe të parashikueshëm, duke mbështetur zhvillimin e tregut dhe ofrimin e shërbimeve me cilësi të lartë për përdoruesit fundorë.
5. Bazuar në nenet 44 dhe 45 të ligjit nr. 54/2024 dhe rregullores “Për procedurat e njoftimit dhe këshillimit publik”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 21, datë

07.12.2021, dokumenti i miratuar nëpërmjet këtij vendimi, do të nxirret për këshillim publik, me qëllim marrjen e mendimit të palëve të interesuara.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 14, dhe pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë për këshillim publik projekt-udhëzimin “Rrjete me kapacitet shumë të lartë”.
2. Procedura e këshillimit publik do të kryhet për një periudhë 30 ditore nga data e publikimit të dokumentit sipas pikës 3 të këtij vendimi.
3. Ky Vendim dhe Dokumenti për këshillim publik: Udhëzimi “Për rrjete me kapacitet shumë të lartë”, të publikohen në faqen e internetit www.akep.al.
4. Ngarkohet Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit të Burimeve të Fundme, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Edlira Dvorani	Armer Juka	Bleron Dokle	Diana Dervishi